

## FORUMI I DEBATI “ DIALOG”

Në datën 9 Maj 2017, me rastin e 67 vjetorit të deklaratës që çoi në krijimin e Bashkimit Evropian, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, të Universitetit “Fan S. Noli”; u mbajt një takim debati mbi BE-në dhe problematikat aktuale. Në këtë takim u dhanë mendime për konceptimin e Bashkimit Evropian si strukturë e rëndësishme globale, politikat e arsimit dhe trajnimit profesional, politikat e punësimit, demokracinë e brendshme, problemet e imigracionit dhe lëvizjes së lirë, etj. Kjo veprimtari u organizua nga **Forumi i Debatit**, i cili është ngritur dy muaj më parë. Forumi ka si qëllim kryesor sensibilizimin e studentëve për t’u organizuar dhe bashkuar zërin, në kontekstin e pluralizmit të mendimit universitar për probleme që shqetësojnë shoqërinë dhe nxisin progresin e saj. I mbështetur nga autoritetet drejtuese të universitetit, **Rektori i Universitetit, Prof. dr. Ali Jashari dhe Dekani i FSHNH-së, Prof. dr. Gjergji Pendavinji**; ky Forum realizoi me sukses veprimtarinë e tij të parë, e cila përkoi me ditën simbolike të Evropës dhe rrugës evropiane të vendit tonë. Në të morrën pjesë pedagogë, student dhe të ftuar të tjerë.

